



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 709/7 Prot.

Tiranë, më 03.04 2026

V E N D I M

Nr. 50 dt. 03.04 2026

**“PËR  
MIRATIMIN E NISJES SË PROCEDURAVE PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË  
PËRBASHKËT “MASTER NË TRAJNIM SPORTIV DHE USHQYERJE”, MIDIS  
UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS, FAKULTETI I SHKENCAVE TË  
LËVIZJES DHE UNIVERSITETIT EUROPIAN TË MADRIDIT, SPANJË**

Mbështetur në nenin 3, 38 dhe 80 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, Udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësave kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, në nenin 7, 20, 73 të Statutit të UST-së, në nenin 7, 54 dhe 55 të Rregullores së UST-së, shkresën nr. 606/2 prot., datë 26.03.2026 të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes “Përcjellje e propozimit për hapjen e Programit të Dyfishtë Master në “Trajnim Sportiv dhe Ushqyerje”, midis Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe Universitetit European të Madridit, Spanjë”, Senati Akademik në mbledhjen e datës 03.04.2026,

V E N D O S I :

1. Miratimin e nisjes së procedurave për hapjen e programit të përbashkët Master në “Trajnim Sportiv dhe Ushqyerje”, midis Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe Universitetit European të Madridit, Spanjë.
2. Ky Vendim i përcillet për njohje, zbatim dhe publikim Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, Bordit të Administrimit si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA

